



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo
Opština Štrpce
Komuna e Shtërpçës
Municipality of Strpce

Në bazë të nenit 12, nenit 17 shkronja (b), neni 40 shkronja (l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenit 5 nënparagrafi 1.2.1 dhe nenit 10, nënparagrafi 2.1, nenit 11.nënparagrafi 1.3, nenit 15, dhe nenit 26 paragrafi 3 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174, datës 31.07.2013 si dhe Udhëzimit Administrativ, nr. 11/2015, Mbi Elementet dhe Kerkesat Themelore per Hartrimin e, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal, dhe nenit 10 dhe 34 të Statutit të Komunës së Shterpces 01-Nr 898 të datës 14/07/2010, Kuvendi i Kornunës së Shtterpces , në mbledhjen e mbajtur më date 29.01.2018, miraon këtë:

VENDIMI
PER
HARTIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL

Neni 1

Me këtë vendim fillohet hartimi Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) per komunen e Shterpces.

Neni 2

Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) , duhet të hartohet si tërësi e hapësirës-teritorit të komunës së Shterpces dhe ka për detyrë të përcaktojë: Vizionin, qëllimin, objektivat dhe caqet e zhvillimit të Komunës, për periudhën 8 vjeqare: 2017-2025, në aspekt të shfrytëzimit dhe të rregullimit të hapsirës si dhe ndërlidhjen e këtij plani me planet apo hapësirat që korrespondojnë dhe përkufizohen me këtë plan, në përputhshmëri me Planin Hapësinor të Kosovës dhe Hartën Zonale të Kosovës.

Neni 3

Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) , nga neni 1 i këtij vendimi planifikohet zhvillimi hapësinor në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor, rregullimit dhe ndërtirnit të teritorit të komunës së Shterpces, me qëllim krijimit të kushteve dhe mundësive për një zhvillim të qëndrueshëm, bashkohorë dhe krijimit të mirëqenjes ekonomike sociale të qytetarëve të komunës së Shterpces.

Neni 4

Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) , përfshinë të gjitha zonat kadastrale, përbrenda teritorit të komunës së Shterpces, ta parapara me Statutin e Komunës së Shterpces,

Neni 5

Bartës i hartimit të planit caktohet: Dreitoria për Planifikim, Rindertim ,Urbanizëm dhe Mbrojtje te Ambientit e Komunës së Shterpces, ne bashkpunim me drejtoritë sektoriale

Neni 6

Mjetet për hartimin e dokumentit të planifikimit hapësinor sigurohen nga buxheti i komunës së Shterpcës.

Neni 7

Bartësi i hartimit të dokumentit të planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij vendimi është i obliguar që dokumentin e planifikimit hapësinor ta hartojë në afat prej: 1. (një) vit nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 8

Projekti i Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) para finalizimit duhet të vihet në konsultime publike dhe në shqyrtim publik. Paraqitja e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen përmes njoftimeve publike.

Neni 9

Dokumenti i planifikimit hapësinor : Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), hartohet për periudhën kohore së paku 8(tetë) vjeqare.

Neni 10

Dokumenti i planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij vendimi duhet të jetë në gjuhët zyrtare të komunës dhe së paku në 3 (kopje) të shtypura e të vulosura dhe 3 kopje digjitale të origjinalit.

Neni 11

Pjesë e këtij vendimi është programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit i paraparë me nenin 11 pika 1.3 të Ligjit për Planifikim Hapësinor, Nr. 04/L-174.

Neni 12

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Predrag Grbic**

